



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.827/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË – Dhoma e shkallës së dytë, Gjyqtarja individual Franciska Zhitija Ymeri në çështjen juridike të paditësit; “R...”sh.p.k me seli në Prishtinë e të cilin e përfaqëson sipas autorizimit S.K avokat nga Lipjani, kundër të paditurës “K...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, e të cilën e përfaqëson sipas autorizimit E.H nga Prishtina, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës të ushtruar nga propozuesi avokat V.B nga Prishtina, kundër aktvendimit, të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.46/20 të datës 21.10.2017, me datën 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pa themeltë propozimi i propozuesit avokat V.B nga Prishtina, për përsëritjen e procedurës, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.46/20 të datës 21.10.2021.

A r s y e t i m

Propozuesi V.B avokat nga Prishtina, me datën; 01.12.2021, ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës në Gjykatën e Shkallës së Parë, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës Ae.nr.46/20 e dt.21.10.2021, me të cilin ka hudhë poshtë si të palejshme ankesën e parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Cështje Ekonomike, IV.EK.nr.18/14 e dates; 09.01.2020, me arsyetimin se mungesa e autorizimit në shkresa të lëndës ka qenë një lëshim i natyrës teknike, e që mund të ndodh sepse autorizimi ka ekzistuar, pra gjykata e Apelit para se të bie aktvendim për moslejshmërinë e ankesës ka mundur të kërkoj nga i autorizuari i të paditurës që të ofroj/dorëzoj autorizimin dhe kështu të vazhdoj me procedurë dhe trajtimin meritore të rastit, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që të aprovon propozimin dhe të lejon përsëritjen e procedurës si dhe të anulon aktvendimet e ankimuar.

Përgjigje në propozim ka paraqitur e paditura, duke i propozuar Gjykatës që të refuzon propozimin për përsëritjen e procedurës si të pa bazuar në ligj.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, me kujdes të shtuar bëri shqyrtimin e shkresave të lëndës, në harmoni me dispozitat e nenit 239 paragrafi 1 e lidhur me nenin 235 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të thënieve të paraqitura në propozim, gjeti se:

Propozimi është i pa themeltë.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar në dispozitivin e parë, ka vendosur të aprovoj pjesërisht si të bazuar kërkespadin e paditësit “R...” sh.p.k me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës “K...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, ashtu që e ka detyruar të paditurën që në emër të borxhit t’ia paguaj shumën 10,885.00 euro, ndërsa në dispozitivin e dytë ka vendosur që ta refuzoj pjesën tjetër të kërkespadi së paditësit për shumën 20,786.77euro. Kështu, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së ushtruar nga avokati V.B nga Prishtina, ka marr aktvendim Ae.nr.46/20 e dates;21.10.2021, me të cilin e ka hedhë poshtë si e palejshme ankesën e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.18/14, e dt.09.01.2020.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, në raport me pretendimet e propozuesit lidhur me përsëritjen e procedurës, ka ardhë në përfundim se nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara sipas nenit 232 pika b) e LPK-së, që të lejohet përsëritja e procedurës në këtë çështje juridike, për këto arsye si vijon: Sipas kësaj dispozite ligjore, ligjvënësi ka paraparë se, *“në qoftë se në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose po që se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, po që se ndjekja e çështjes në gjyq apo kryerja e veprimeve procedurale të caktuara nuk është lejuar me vonë nga pala”*. Në rastin konkret, avokati është person profesional dhe është themelore që me rastin e dorëzimit të ankesës të dorëzohet edhe autorizimi, bile deri në fazën e shqyrtimit tek gjykata e shkallës së dytë, shifet edhe nga shkresat e lëndës se avokati në fjalë si nënshkruer i ankesës nuk e ka përfaqësuar palën e paditur për gjatë procedurës të shkallës së parë. Në fazën e ankesës është paraqitur me ankesë, por pa e mbështetë ankesën me autorizim, ndërsa ankesën e ka dorëzuar vetëm me propozim për përsëritje të procedurës, andaj e njëjta nuk ka figuruar në shkresa të lëndës, ndërsa pala e paditur ka qenë i përfaqësuar nga avokati E.H i cili ka pasur autorizim në shkresa të lëndës, andaj në bazë të nenit 239 paragrafi 1 pika b), gjykata vlerëson se janë të pabazuar pretendimet e propozuesit të dhëna në propozim për përsëritje të procedurës.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë konform nenit 239 paragrafi 1 pika b), të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke refuzuar përsëritjen e procedurës.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë
K.Dh.shk.II.nr.827/2022, me datë 05.09.2022

Gjyqtari individual
Franciska Zhitija Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, prej ditës së dorëzimit, trupit gjykues të Gjykatës së Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, sipas nenit 240.4 të LPK-së.